



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 429/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar

Në mbledhjen e datës 25.06.2018 shqyrtoi ankesat përkatësisht me:

Objekt:

Shfuqizim i vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “Sinani Trading” sh.p.k. & “AB-Gersa” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-57002-03-19-2018, me objekt: “Blerje ushqime blegtorale për Konviktet e Shkollave të Mesme”, me fond limit 5.547.756 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 30.03.2018, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme.

Shfuqizim i vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Kadra” sh.p.k., në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Ankimues:

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Sinani Trading” sh.p.k. & “AB-Gersa” sh.p.k.
Lagja “Xhevdet Nepravishta”, Rruga “Iljaz Ahmeti”, pranë Fabrikës së Qumështit, Lushnje

Autoriteti Kontraktor:

Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme
Rruga “Jeronim De Rada”, Konvikti i Ekonomikut, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 20.03.2018, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me nr. REF-57002-03-19-2018, me objekt: “Blerje ushqime blegtorale për Konviktet e Shkollave të Mesme”, me fond limit 5.547.756 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 30.03.2018, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme.

II.2. Në datën 30.03.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor, ky i fundit në datë 04.04.2018 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi si më poshtë, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH) përkatësisht:

1. "Lel" sh.p.k.	3.986.200	lekë, skualifikuar
2. "Dogel" sh.p.k.	4.003.900	lekë, skualifikuar
3. "Kadra" sh.p.k.	4.668.050	lekë, kualifikuar
4. Bashkimi i operatorëve ekonomikë "Sinani Trading" sh.p.k. & "AB Gersa" sh.p.k.	4.682.500	lekë, skualifikuar
5. "Nelsa" sh.p.k.	4.808.950	lekë, kualifikuar

II.4. Në datën 04.04.2018 bashkimi i operatorëve ekonomikë "Sinani Trading" sh.p.k. & "AB Gersa" sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi, për arsyet si më poshtë vijon:

[...]

1. Operatori ekonomik "AB-GERSA" si anetar i bashkimit të operatorëve ekonomik nuk ka paraqitur licence të leshuar nga qendra kombetare e licencimit për produktet me origjinë shtazore. Ka marrë persiper të realizojë 40% të furnizimit të mallit duhet të paraqesë licencën për produktet me origjinë shtazore. Pra sa më sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomik "SINANI TRADING" shpk & "AB-GERSA" shpk në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për "Prokurimin publik", i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik", e ndryshuar e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2. Operatori ekonomik "SINANI TRADING" ka paraqitur therrtore po nuk ka QKL për thertoren.

3. Operatori ekonomik "AB-GERSA" si anetar i bashkimit të operatorëve ekonomik nuk ka paraqitur taksat vendore për vitin 2016 duke mos plotësuar kriteret e vecanta për kualifikim ku citohet: • Operatori ekonomik duhet të paraqesë vertetim mbi shlyerjen e taksave vendore për vitet 2016,2017 në të gjitha pikat e ushtrimit të aktivitetit sipas ekstraktit të shoqerise.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Komuna ose Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKR)

4. Operatori ekonomik "AB-GERSA" si anetar i bashkimit të operatorëve ekonomik nuk ka paraqitur xhiron për vitin 2014 duke mos plotësuar kriteret e vecanta për kualifikim ku citohet:

• Vertetim nga Administrata Tatimore për xhiron mesatare vjetore të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit, ku vlera mesatare e xhiros gjatë tre viteve të fundit (2014, 2015 dhe 2016) të ketë një vlerë minimalisht 5.547.756 (pesë milion e pesëqind e dyzet e shtatë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh lëshuar nga Autoriteti perkates.

5. Operatori ekonomik "AB-GERSA" si anetar i bashkimit të operatorëve ekonomik në lidhje me therrtoren nuk ka paraqitur leje mjedisore e tipit C kategoria III.1.A "Për therrtore" sic është kerkuar në kriteret e vecanta për kualifikim por leje mjedisore me kategorinë III.1.B "Për mbareshtim të kafsheve të gjalla" duke mos plotësuar Kriteret e vecanta për kualifikim Kapaciteti Teknik. Sa më sipër asnjë nga operatorët ekonomik nuk plotëson dokumentacionin për kompleks stallor, therrtore duke mos plotësuar kriteret e vecanta për kualifikim, kapaciteti teknik.

II.5. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe pretendimeve të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimes, në datën 10.04.2018 ky i fundit ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike, në procedurën e mësipërme të prokurimit. Gjithashtu bashkimi i operatorëve ekonomikë “Sinani Trading” sh.p.k. & “AB Gersa” sh.p.k. ngre pretendime mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Kadra” sh.p.k., duke pretenduar si më poshtë vijon:

[...] Ne analizuam me kujdes arsyetimin e s'kualifikimit dhe gjykojme se ai është teresisht i padrejte dhe i pabazuar.

Ne lidhje me arsyetimin e pare te KVO sqarojme se: Operatori ekonomik Sinani Trading shpk nuk ka paraqitur thertore dhe as QKL per thertore. Ky kriter është i permbushur nga operatori tjetër ne BOE AB-GERSA shpk i cili disponon thertoren dhe licensen perkatese.

Ne lidhje me arsyetimin e dyte te KVO sqaroj me se: Operatori ekonomik AB-GERSA shpk kriterin e pikes c mbi kapacitetin ekonomik dhe financiar te kriterëve te vecanta, e ka permbushur duke paraqitur nje vertetim te vetem Nr 785 Prot Dt 01/02/2018 ne te cilin percaktohet se shoqeria AB-GERSA shpk ka paguar taksat dhe tarifat vendore per biznesin per vitet 2017 dhe nuk ka detyrime ndaj kesaj drejtorie, Bashkia Lushnje deri me dt 31/12/2017.

Ne lidhje me arsyetimin e trete te KVO sqarojme se: Shoqeria AB-GERSA shpk ka paraqitur vertetimin Nr 496 Prot Dt 06/02/2018 mbi xhiron e tre viteve te fundit e cila sic mund te shihet është shume here me e larte se vlera e kerkuar prej 5.547.756 leke.

Ne lidhje me arsyetimin e katert te KVO sqarojme se: Operatori ekonomik AB-GERSA shpk ka paraqitur lejen mjedisore PN-2750-01-2012 me kod 111.1.B dhe me objekt “Mbareshtim dhe therje kafshesh”, nderkohe qe ne aktin e miratimit te lejes mjedisore percaktohet aktiviteti “Kompleks blegtoral per mbareshtim kafshesh dhe thertore”. Sqarojme akoma me tej se bazuar ne ligjin Nr. 10 448, datë 14.7.2011, leja mjedisore me kod 111.1.B percakton se kompleksi blegtoral ka kapacitet mbareshtimi dhe therje me te madh se leja mjedisore me kod "1.1.C.

Ne lidhje me arsyetimin e peste te KVO sqarojme se: Operatori ekonomik AB-GERSA shpk ka paraqitur dokumenacionin perkates ne lidhje me volumin e punes qe kjo shoqeri do te mbuloje: mbareshtimi i kafsheve dhe therja e tyre. Licensa per produktet me origjine shtazore është paraqitur nga anetari tjetër i BOE Sinani Trading shpk duke platesuar keshtu kriterin e kerkuar nga AK.

Nga ana tjetër shprehim shqetesim ne lidhje me kualifikimin e operatorit KADRA shpk. Referuar konkurimeve te meparshme me kete operator ekonomik si dhe ekstratit online te QKB i cili figuron me vetem nje adrese ushtrimi aktiviteti, ky subjekt nuk disponon dokumentat si me poshte:

- 1. Kompleks stallor, therrorë ne pronesi ose ne prrdorim sipas kontrats noteriale jo me pak se 150 m2 ku te vertetohet me adrese vendndodhja, planimetria dhe gjurma ne harten rajonale ne menyre qe Komisioni i Vleresimit te Ofertave te kete mundesi verifikimi.*
- 2. Operatori ekonomik për Thertoren të jetë i pajisur me leje mjedisore të tipit C.*
- 3. Aktin e miratimit të lejes mjedisore të tipit C për therrtorë të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Mjedisit.*
- 4. Licencen e leshuar nga Qendra Kombëtare e licencimit QKL për therrtorë.*
- 5. Aktin e miratimit higjeno-sanitar te leshuar nga Inspektoriat Shendetesor per thertore.*

6. *Operatori nuk disponon ne pronesi (vertetuar me akti i pronesise kopje e noterizuar) ose ne perdorim kundrejt kontratave perkatese te noterizuara te ambjenteve te pershtatshme frigoriferike per tregetin dhe magazinimin e bulmetit. (paisur me leje higjeno sanitare).*
7. *License e leshuar nga Qendra Kombetare e Licensimit per produktet me origjine shtazore.*
8. *Automjet te pershtatshem (frigoriferik ATV) per artikujt bulmet dhe mish (2 cope). Per automjetet te paraqiten certifikatat e pronesise, kontratat e dhurimit apo te qirase sipas rastit, si dhe dokumentacionin perkates Certifikatat e kontrollit teknik, lejet e qarkullimit dhe Siguracion te automjeteve ne dispozicion si dhe leje per transport mallrash. (dokumentacioni i kerkuar te jete i vlefshem ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi).*
9. *Leje higjeno-sanitare per mjetet qe bejne transportin e produkteve ushqimore frigoriferike, leshuar nga Drejtoria e Shendetit Publik e rrethit ku ushtron aktivitetin perkates, i vlefshem per periudhen e realizimit te objektit te kontrates.*
10. *Cenifikate ISO 9001-2008 Certifikate ISO 22000-2005 Certifikate HACCP (e vlefshme per te gjitha periudhen e realizimit te kontrates).*

Per sa me siper argumentuam, kerkojme pezullimin e vazhdimit te procedures dhe Kualifikimin e ofertes se BOE "SINANI TRADING shpk & AB-GERSA shpk", si oferte qe ploteson te gjitha kushtet kualifikuese te percaktuara ne DST. S'kualifikimin e ofertes se shoqerise KADRA shpk si oferte e cila nuk i ploteson te gjitha kriteret kualifikuese te kerkuara ne DST.

II.6. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor në datën 12.04.2018, nëpërmjet shkresës me nr. 274 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimes, duke e pranuar pjesërisht ankesën. Konkretisht autoriteti kontraktor ka pranuar pretendimin lidhur me QKL për thertore dhe ka refuzuar pretendimet e tjera, me argumentin si më poshtë vijon:

[...]

1. Ne lidhje me pretendimin qe operatori ekonomik "Sinani Trading" shpk nuk ka paraqitur therrtore dhe as QKL per therrtore por ky kriter plotesohet nga operatori tjetër ekonomik pjese e BOE "ABGersa" shpk sqarojme sa me poshte vijon: Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pas shqyrtimit dhe verifikimit të dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik në sistemin elektronik të prokurimit ne lidhje me këtë pike konkludon se: Bashkimi i operatorëve ekonomik "Sinani Trading" shpk & "ABGersa" shpk ka paraqitur ne plotesim të kësaj pike nje kompleks stallor, therrtore të marrë me qera me anë të kontratës së qerese Nr.887 Rep, Nr.337 Kol, date 13.07.2013 per te cilin rezulton se ka paraqitur te gjitha dokumentacionin e kerkuar nga Autoriteti Kontraktor ne kriteret e vecanta per kualifikim. Referuar dokumentacionit te paraqitur konstatohet fakti qe operatori ekonomik ka paraqitur Leje mjedisore te tipit B por KSHA giykon se kjo leje e tipit B e paraqitur nga operatori ekonomik "AB-Gersa" mund te konsiderohet e vlefshme pasi referuar ligjit 10448, date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit" ka mbareshtim dhe thenje kafshesh me kapacitet me te madh se leja mjedisore e Tipit C. Ne keto kushte Komisioni i Shqynimit te Ankesave giykon se kerkesa e vendosur nga Autoriteti Kontraktor per Thertoren plotesohet nga operatori ekonomik "AB-Gersa" i cili ka paraqitur leje mjedisore te tipit B e cila mbase ka kapacitet mbareshtimi dhe therrje me te larte se leja mjedisore e tipit C duhet te konsiderohet e Vlefshme pasi operatori ekonomik ploteson kapacitetet teknike dhe profesionale ne lidhje me kete pike. Nisur nga sa u citua me siper pretendimi i operatorit ekonomik ankimes ne lidhje me kete pike qendron.

2. Ne lidhje me pretendimin e ngritur nga ana jua si operator ekonomik per pagesen e taksave dhe tarifave vendore ne si komision i shqyrtimit te ankeses gjykojme sa me poshte vijon: Ne kriteret e vecanta per kualifikim, Kapaciteti ekonomik dhe financiar Autoriteti Kontraktor ka kerkuar specifikisht: a. Operatori ekonomik duhet te paraqese vertetim mbi shlyerjen e taksave vendore per vitet 2016, 2017 ne te gjitha pikat e ushtrimit te aktivitetit sipas ekstraktit te shoqerise. (Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomike, cdo anetar i grupit duhet te dorezoje vertetimin leshuar nga Komuna ose Bashkia ne te cilen eshte regjistruar sipas QKR).

Nga verifikimi i kryer nga KSHA për plotësimin e kriterit të mësipërm konstatohet se operatori ekonomik "AB-Gersa" shpk ka paraqitur vërtetimin Nr. 785 Prot, date 01.02.2018 të leshuar nga Bashkia Lushnje ne te cilin specifikohet se jane shlyer detyrimet ndaj Bashkise Lushnje per vitin 2017 dhe nuk permendet ne vertetimin e leshuar shlyerja e taksave vendore per vitin 2016 sic eshte kerkuar ne kriterete vecanta per kualifikim ku specifikohet qe vertetimi te jete i leshuar per te dy vitet vertetim mbi shlyerjen e taksave vendore per vitet 2016, 2017. Në këto kushte Komisioni i shqyrtimit të ankesave gjykon se operatori ekonomik referuar kriterëve të vendosura nga Autoriteti Kontraktor ne dokumentat e tenderit duhet te paraqiste edhe vertetimin per shlyerjen e taksave vendore per vitin 2016. Në nenin 46, pika 1/c te LPP [...]. Neni 53, pika 3 i LPP percakton [...]. Nisur nga sa u citua me siper pretendimi i operatorit ekonomik ankimues ne lidhje me kete pike nuk qëndron.

3. Ne lidhje me pretendimin e ngritur nga ana jua si operator ekonomik per xhiron mesatare vjetore ne si komision i shqyrtimit te ankeses gjykojme sa me poshte vijon: Ne kriteret e vecanta per kualifikim, Kapaciteti ekonomik dhe financiar Autoriteti Kontraktor ka kerkuar specifikisht: Vertetim nga Administrata Tatimore per xhiron mesatare vjetore te realizuar gjate 3 (tre) viteve te fundit, ku vlere mesatare e xhiros giate tre viteve te fundit (2014, 2015 dhe 2016) te kete nje vlere minimalisht 5.547.756 lekë pa tvsh lëshuar nga Autoriteti perkates. Nga verifikimi i kryer nga KSHA për plotësimin e kriterit të mësipërm konstatohet se operatori ekonomik "AB-Gersa" shpk ka paraqitur vërtetimin Nr. 496 Prot, date 06.02.2018 të lëshuar nga Administrata tatimore ne te cilen nuk eshte e perfshirë xhiro e vitit 2014 sic është përcaktuar në kriteret e vecanta për kualifikim. Sqarojme se Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar vitet per të cilat operatori ekonomik duhet të paraqese xhiron vjetore dhe operatori ekonomik duhet te plotesoje kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor ne mbeshtetje te nenit 46, pika 1/c te ligjit nr.9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar [...]. Gjithashtu në ligjin m. 9643 date 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, neni 53, pika 3 përcaktohet se: "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji." Në rastin konkret mosparaqitja e dokumentacionit të kërkuar e bën automatikisht ofertën e ankimuesit të papranueshme në kuptim dhe të nenit 1 dhe 2 të LPP i cili parashikon se: "Qëllimi i këtij ligji është: [...] të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik"; Operatorët ekonomike jane te detyruar te përgatisin ofertat, ne perputhje me kerkesat e percaktuara ne dokumentat e tenderit dhe ofertat qe nuk pergatiten ne perputhje me keto dokumenta duhet të refuzohën si të papranueshme. Nisur nga sa u citua me siper pretendimi i operatorit ekonomik ankimues ne lidhje me këtë pikë nuk qëndron.

4. Ne lidhje me pretendimin e ngritur nga ana juaj si operator ekonomik per licencen e leshuar nga QKL per produktet me origjine shtazore ne si komision i shqyrtimit te ankeses gjykojme si me

poshte vijon: Nga verifikimi i dokumenacionit te operatorit ekonomik "AB-GERSA" shpk ne plotesim te kriterit te mesiperme konstatojme se operatori ekonomik "ABGersa" shpk si anetari bashkimit te operaërevc ekonomik " Sinani Trading" shpk & "ABGersa" shpk i krijuar zyrtarisht me ane te komrates se bashkepunimit Nr.881 Rep, Nr.612 Kol ka marrë përsipër të realizoje 40% të volumit të kontratës. Thënë kjo operatori ekonomik qe të lejohet te ushtrojë veprimtarine te cilen ka marre përsipër referuar kontratës së bashkëpunimit detyrimisht duhet te jete i licensuar sikunder dhe operateret e tjeter ekonomik pjese e ketij bashkimi. Operatori ekonomik "ABGersa" shpk ka marre persiper te kryeje nje veprimtari kryerja e te ciles i nenshtrohet procesit te licencimit referuar Ligjit 10081, datë 23.02.2009 "Per licencat, autorizimet dhe lejet ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar. Pra detyrimisht operatori ekonomik duhet te paraqiste licencen per produktet me origjine shtazore. Ne keto kushte Komisioni i shqyrtimit te ankesave gjykon se operatori ekonomik "AB-Gersa" shpk referuar kritereteve te vendosura nga Autoriteti Kontraktor dhe kontrates se bashkepunimit duhet detyrimisht te paraqiste edhe licencen per produktet me origjine shtazore. Ne nenin 46, pika 1/c te ligjit nr.9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: "Operatoret ekonomike, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet te kualitikohen, pasi te kene përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. Neni 53 i LPP [...].

Nisur nga sa u citua mu sipur pretendimi i operatorit ekonomik ankimues ne lidhje me këtë pikë nuk qëndron.

Duke u nisur nga sa u refcrua me siper, Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, vendosi te pranoje pjeserisht ankesen e bashkimit te operatoreve ekonomik "Sinani Trading" shpk & " AB-Gersa" shpk. Gjendja faktike dhe juridike e bashkimit te operatoreve ekonomike edhe pas arsyetimit te bere nga Komisioni i shqyrtimit te ankesave nuk do te ndryshoje duke mbetur i skualifikuar ne procedurën e prokurimit me objekt: "Blerje ushqime blegtorale per Konviktet e Shkollave të Mesme".

Ne ankimimin e bere prane autoritetit kontraktor bashkimi i operatorëve ekonomik "Sinani Trading" shpk & "AB-Gersa" shpk ka kundërshtuar dhe kualifikimin e operatorit ekonomik "Kadra" shpk duke parashtruar pretendimet si më poshtë vijon [...]

Pas shqyrtimit të pretendimeve të pales ankimuese, mbi s'kualifikimin e operatorit ekonomik "Kadra" sh.p.k., Komisioni i shqyrtimit të ankesave gjykon se këto të fundit nuk qëndrojnë dhe në (këtë mënyrë lë në fuqi vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofeitave të datës 04.04.2018 dhe gjendja faktike juridike e operatorit ekonomik "Kadra" sh.p.k. mbetet e kualifikuar, e renditur e para me oferte me te ulet ekonomike.

Sa më sipër, Komisioni i Shqynimit të Ankesave vendosi që meqënëse pretendimet tuaja qëndrojnë pjesërisht dhe gjendja faktike dhe juridike e BOE nuk ndryshon të vazhdojë më tej me procedurën e prokurimit.

II.7. Në datën 16.04.2018 bashkimi i operatorëve ekonomikë "Sinani Trading" sh.p.k. dhe "AB-Gersa" sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke ngritur të njëjtat pretendime si në autoritetin kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr. 317 prot., datë 26.04.2018, protokolluar me tonën në datën 27.04.2018 me objekt "Dërgim informacioni", është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik

informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Sinani Trading” sh.p.k. dhe “AB-Gersa” sh.p.k. për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij ekonomike me arsyetimin se *“Lidhur me arsyen e skualifikimit se operatori ekonomik “AB-GERSA” si anetar i bashkimit te operatoreve ekonomik nuk ka paraqitur licence te leshuar nga qendra kombetare e licencimit per produktet me origjine shtazore, sqarojme se: Operatori ekonomik AB-GERSA shpk ka paraqitur dokumenacionin perkates ne lidhje me volumin e punes qe kjo shoqeri do te mbuloje: mbareshtimi i kafsheve dhe therja e tyre. Licensa per produktet me origjine shtazore eshte paraqitur nga anetari tjetër i BOE Sinani Trading shpk duke platesuar keshtu kriterin e kerkuar nga AK”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, në shtojcën nr. 8, pika 2.3. “Kapaciteti teknik”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin:

- *“License e leshuar nga Qendra Kombetare e Licencimit per produktet me origjinë shtazore”*.

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, rezulton se, është paraqitur dokumenti me emërtimin *“Kontratë Për Marrëveshje Për Bashkim Operatorësh Ekonomikë”*, ndërmjet shoqërisë “AB Gersa” sh.p.k. dhe shoqërisë “Sinani Trading” sh.p.k., nga ku shoqëria “ AB Gersa” sh.p.k. merr përsipër të përballojë 40 % të volumit të kontratës dhe shoqëria “Sinani Trading” sh.p.k. merr përsipër të përballojë 60 % të volumit të kontratës. Gjithashtu është paraqitur edhe dokumenti *Prokurë e Posaçme*, sipas së cilës shoqëria “Sinani Trading” sh.p.k. është përfaqësuese e këtij bashkimi operatorësh ekonomikë.

III.1.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, konstatohet se është paraqitur dokumentacioni i mëposhtëm:

- Licencë lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit për veprimtarinë *“Shitje me shumicë e ushqimeve me origjinë shtazore”*, në emër të shoqërisë “Sinani Trading” sh.p.k.
- Licencë lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit për veprimtarinë *“Thertore (Derra, gjedh, të imta)”*, në emër të shoqërisë “AB-Gersa” sh.p.k.
- Licencë lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit për veprimtarinë *“Thertore (Derra, gjedh, të imta)”*, në emër të shoqërisë “AB-Gersa” sh.p.k.
- Licencë lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit për veprimtarinë *“Tregti me shumicë e kafshëve të gjalla (Derra, gjedh, të imta)”*, në emër të shoqërisë “AB-Gersa” sh.p.k.

- Leje mjedisore lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit për veprimtarinë “Mbarështim dhe therje kafshësh”, në emër të shoqërisë “AB-Gersa” sh.p.k.
- Licencë lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit për veprimtarinë “Mbarështim i kafshëve të gjalla (Derra, gjedh, të imta)”, në emër të shoqërisë “AB-Gersa” sh.p.k.
- Licencë lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit për veprimtarinë “Tregti me shumicë e kafshëve të gjalla (Derra, gjedh, të imta)”, në emër të shoqërisë “AB-Gersa” sh.p.k.
- Akt miratimi Leje mjedisore lëshuar nga Ministria e Mjedisit, nr.140/15, datë 11.01.2012 për veprimtarinë “Kompleks blegtoral për mbarështim kafshësh dhe thertore”, në emër të shoqërisë “AB-Gersa” sh.p.k.

III.1.4. Bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues pretendon se: *“Ne lidhje me arsyetimin e KVO sqarojme se: Operatori ekonomik AB-GERSA shpk ka paraqitur dokumentacionin perkates ne lidhje me volumin e punes qe kjo shoqeri do te mbuloje: mbareshtimi i kafsheve dhe therja e tyre. Licensa per produktet me origjine shtazore eshte paraqitur nga anetari tjetër i BOE Sinani Trading shpk duke platesuar keshtu kriterin e kerkuar nga AK.”*

III.1.5. Autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes drejtuar bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues argumenton se:

Ne lidhje me pretendimin e ngritur nga ana juaj si operator ekonomik per licencen e leshuar nga QKL per produktet me origjine shtazore ne si komision i shqyrtimit te ankeses gjykojme si me poshte vijon: Nga verifikimi i dokumentacionit te operatorit ekonomik “AB-GERSA” shpk ne plotesim te kriterit te mesiperm konstatojme se operatori ekonomik “ABGersa” shpk si anetari bashkimit te operaerevc ekonomik “Sinani Trading” shpk & “ABGersa” shpk i krijuar zyrtarisht me ane te komrates se bashkepunimit Nr.881 Rep, Nr.612 Kol ka marrë përsipër të realizoje 40% të volumit të kontratës. Thënë kjo operatori ekonomik qe të lejohet te ushtrojë veprimtarine te cilen ka marre përsipër referuar kontratës së bashkëpunimit detyrimisht duhet te jete i licensuar sikunder dhe operateret e tjetër ekonomik pjese e ketij bashkimi. Operatori ekonomik “ABGersa” shpk ka marre persiper te kryeje nje veprimtari kryerja e te ciles i nenshtrohet procesit te licencimit referuar Ligjit 10081, datë 23.02.2009 “Per licencat, autorizimet dhe lejet ne Republiken e Shqiperise”, i ndryshuar. Pra detyrimisht operatori ekonomik duhet te paraqiste licencen per produktet me origjine shtazore. Ne keto kushte Komisioni i shqyrtimit te ankesave gjykon se operatori ekonomik “AB-Gersa” shpk referuar kriterëve te vendosura nga Autoriteti Kontraktor dhe kontrates se bashkepunimit duhet detyrimisht te paraqiste edhe licencen per produktet me origjine shtazore. Ne nenin 46, pika 1/c te ligjit nr.9643, date 20.11.2006 “Per prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatoret ekonomike, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet te kualitikohen, pasi te kene përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. Neni 53 i LPP [...]”.

Nisur nga sa u citua mu sipur pretendimi i operatorit ekonomik ankimues ne lidhje me këtë pikë nuk qëndron.[...]”.

III.1.6. Nga verifikimi i ofertës së paraqitur nga bashkimi i përkohshëm i shoqërive të mësipërme rezulton se ka mangësi në plotësimin e kriterit për licencën për produktet me origjinë shtazore, pasi referuar kontratës së bashkëpunimit të cilën bashkimi i shoqërive ”Sinani Trading” sh.p.k. dhe ”AB-Gersa” sh.p.k. kanë paraqitur në sistemin e prokurimit publik për këtë procedurë prokurimi, konstatohet se shoqëria “AB Gersa” sh.p.k. merr përsipër të përballojë 40 % të volumit të kontratës dhe shoqëria ”Sinani Trading” sh.p.k. merr përsipër të përballojë 60 % të volumit të

kontratës. Sa më sipër, referuar kësaj kontrate bashkëpunimi, secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të plotësojë kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor në përputhje me përqindjen e marrë përsipër për të gjithë volumin e kontratës. Akoma më tej, operatori ekonomik "AB-Gersa" sh.p.k. pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, pranon se kriteri për licencën për produktet me origjinë shtazore është plotësuar vetëm nga anëtari tjetër i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues "Sinani Trading" sh.p.k. Lidhur me këtë pretendim, KPP sqaron se, për sa kohë në kontratën e bashkëpunimit deklarohet se secili prej anëtarëve merr përsipër një përqindje të caktuar të të gjithë volumit të kontratës (konkretisht "AB-Gersa" sh.p.k. 40 % dhe "Sinani Trading" sh.p.k. 60%), atëherë është e detyrë e secilit prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, të plotësojë kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në përputhje me përqindjen e marrë përsipër. Pra, duke qenë se operatori ekonomik "AB Gersa" sh.p.k. pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues do të realizojë 40% të volumit të të gjithë kontratës (ku përfshihen zërat Mish Viçi, Mish Pule, Salçiçe, Gjalp, Djath i Bardhë, Vezë, Qumësht, Kos Natyral), atëherë është gjithashtu detyrë e këtij operatori ekonomik të paraqesë licencën e kërkuar dhe të mos justifikohet me faktin se është paraqitur nga operatori tjetër pjesë e bashkimit.

Rrjedhimisht, referuar përqindjes së përcaktuar në kontratën e bashkëpunimit të lidhur ndërmjet operatorëve ekonomikë "Sinani Trading" sh.p.k. & "AB Gersa" sh.p.k., bazuar në dokumentacionin e paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike, për sa kohë që nga secili prej anëtarëve merret përsipër kryerja e furnizimeve të të gjithë produkteve të kontratës sipas përqindjes së marrë përsipër, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, operatori ekonomik "AB Gersa" sh.p.k. nuk përmbush kriterin e përcaktuar në dokumentat e tenderit, pasi nuk plotëson kërkesën për licencë për produktet me origjinë shtazore.

III.1.7. Në Kreun VIII, neni 74, "Bashkimi i operatorëve ekonomikë", pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, parashikohet: *"Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi"*. Në Kreun VIII, neni 74, pika 2 po këtu, parashikohet: *"Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi..."*, ndërsa në pikën 3 parashikohet: *"Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje"*.

III.1.8. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *"Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese."* Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643,

datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*.

III.1.9. Sqarojmë se, referuar rregullave të prokurimit publik, përmbushja e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e shërbimeve të marra përsipër. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Sinani Trading” sh.p.k. & “AB Gersa” sh.p.k., nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi operatori ekonomik “AB Gersa” sh.p.k. nuk e plotëson kërkesën për licencën për produktet me origjinë shtazore, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit. Operatori ekonomik “AB Gersa” sh.p.k. nuk ka paraqitur dokument për të provuar se zotëron licencë për produktet me origjinë shtazore në përputhje me pjesën e përqindjes së marrë përsipër, fakt ky i pranuar edhe nga vetë operatori ekonomik “AB Gersa” sh.p.k., i cili sqaron se kjo licencë është paraqitur nga operatori tjetër pjesë e bashkimit. Sqarojmë se, bazuar edhe në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, barra e provës për të vërtetuar plotësimin e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, bie mbi operatorin ekonomik, i cili në rastin konkret ka dështuar ta vërtetojë atë.

Nuk mund të lejohet kualifikimi i një operatori ekonomik në rast se ai ka mungesë dokumentacioni dhe nuk plotëson kriteret e përcaktuara nga vetë autoriteti kontraktor.

III.1.10. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, në rast se, operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”*.

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte

paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”.

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Sinani Trading” sh.p.k. dhe “AB Gersa” sh.p.k. mbi skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron dhe operatori ekonomik ankimues nuk përmbush kriteret e veçanta të kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsytimit të K.P.P. mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.3. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Sinani Trading” sh.p.k. dhe “AB Gersa” sh.p.k. për skualifikimin e operatorit ekonomik “Kadra” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se:

III.3.1. Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), me titull “Të drejtat e personit të interesuar” parashikon se: “Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin”.

III.3.2. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të paraqesë (argumentojë) se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP është i papranueshëm.

Neni 63, pika 1, kërkon shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor.

Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk ka ndonjë interes të ligjshëm për të mbrojtur. Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk arrin të realizojë interesin e tij të ligjshëm.

Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real (*përkundrejt atij imagjinar*) nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Sa më sipër, në rastin konkret, për sa kohë gjendja faktike dhe juridike e bashkimit të operatorëve ekonomik “Sinani Trading” sh.p.k. dhe “AB Gersa” sh.p.k. pas arsyetimit të KPP mbetet e skualifikuar, rrjedhimisht pretendimet e këtij të fundit mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Kadra” sh.p.k. nuk merren në shqyrtim, pasi ky bashkim i operatorëve ekonomikë ankimes nuk legjitimohet,

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “*Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomik “Sinani Trading” sh.p.k. dhe “AB Gersa” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me nr. REF-57002-03-19-2018, me objekt: “*Blerje ushqime blegtorale për Konviktet e Shkollave të Mesme*”, me fond limit 5.547.756 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 30.03.2018, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Konvikteve të Shkollave të Mesme.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 762 Protokolli

Datë 16.04.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Kryetar
Evis Shurdha